ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit N/A-25-4874-1-1-1

Nr i brendshëm

Sa i përket tenderit për "Furnizim me Gdhendla Druri - (Biomasë)"

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"ETNIKU GROUP" SH.P.K

Rruga Lagjja e Shehut, p.n, Republika e Kosovës

GJAKOVĒ *50000*

+383 45 541 052

Arben Krasniqi

benikrasniqi83@gmail.com

02/07/2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Aktiviteti i prokurimit "Furnizim me Gdhendla Druri - (Biomasë)" **është publikuar me datë 02/06/2025 në eprokurim.** Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është 09/07/2025 në ora 14:00. Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Aktiviteti i prokurimit është në proces të ofertimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik në nenet në vijim: - **Neni 1 Qëllimi;** - **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;** - **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;**

- **Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës;**
- **Neni 35 Kriteret e përzgjedhjes.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kronologjia e ngjarjes dhe dispozitat e shkelura të LPP dhe legjislacionit sekondar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Gdhendla Druri - (Biomasë)" me Nr. e Prokurimit N/A-25-4874-1-1-1
Kërkesa jonë për rishqyrtim ngre shqetësime për çështjet në vijim:

1. Parashikimi jo real i vlerës së kontratës; dhe
2. Përcaktimi i kritereve diskriminuese për OE dhe që e kufizojnë konkurrencën.

Çështja e parë: Parashikimi jo real i vlerës së kontratës
Vlera e parashikuar e kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Gdhendla Druri - (Biomasë)" për vitin 2025 është 990,000.00 € në total, apo 99.00 €/ton (990,000.00 € / 10,000 ton). Parashikimi i vlerës së kontratës është bërë në mënyrë jo realiste, pa u bazuar në çmimet e tregut dhe në kundërshtim me nenin 13 të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP), në të cilin thuhet *"Në parashikimin e vlerës së kontratës, AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj., me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim."*

Madje, AK nuk e ka marrë për bazë as çmimin e parashikuar në vitin e kaluar. Në vitin 2024, vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 900,000 €, apo 100 €/ton (900,000 €/9,000 ton). Edhe pse sasia për vitin 2025 është më e madhe, çmimi për njësi është më i ulët, çka tregon për një ulje joreale të çmimit, në kundërshtim me logjikën e tregut dhe zhvillimet ekonomike aktuale.
Përveç shkeljeve të dispozitave të LPP dhe legjislacionit sekondar nga parashikimi jo real i vlerës së kontratës, AK mund t'i paraqiten dëmet në vijim:

- Mungesë në konkurrencë, sepse OE nuk do të dorëzojnë oferta për një aktivitet prokurimi ku vlera e parashikuar e kontratës është më e ulët se kostoja reale.
- Mund të paraqiten oferta me çmimin e planifikuar, që është më i ulët se çmimi i tregut, vetëm për të fituar kontratën. Mirëpo OE më pas nuk është në gjendje ta përmbushë kontratën. Kjo sjell produkt me cilësi të dobët, vonesa në zbatimin e kontratës apo ndërprerje të kontratës në kohën kur AK i duhet furnizimi, duke e penguar atë në realizimin e veprimtarisë së tij.
- Procedura mund të dështojë dhe AK do të jetë i detyruar ta ritenderoj aktivitetin e prokurimit me vlerë reale të parashikuar, por që do të kërkojë shtyrje të afateve të zbatimit të kontratës, duke shkaktuar vonesa në ofrimin e shërbimit për publikun.

Për më tepër, përcaktimi i çmimit në këtë mënyrë rrit rrezikun edhe për shkelje të tjera gjatë ekzekutimit të kontratës.

Prandaj, kërkojmë nga AK Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A që ta rishqyrtojë vlerën e parashikuar të kontratës, duke u bazuar në çmimin real të tregut si faktor kyç për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu, e inkurajojmë që të respektojë dhe zbatojë parimin e konkurrencës së drejtë, me qëllim të sigurimit të furnizimeve cilësore dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).

Çështja e dytë: Përcaktimi i kritereve diskriminuese për OE dhe që e kufizojnë konkurrencën
Autoriteti Kontraktues (AK), në këtë rast "Ngrohtorja e Qytetit Gjakova SH.A", ka vendosur si kriter për kapacitetin teknik dhe profesional që lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE), në rast bashkimi (konzorciumi), të ketë realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë prej së paku 60% të shumës 1,485,000.00€, brenda tre (3) viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.
Vendosja e këtij pragu të lartë – 60% për liderin e GOE – përjashton një numër të madh të operatorëve ekonomikë që kanë kapacitete të fuqishme në bashkëpunim, por që individualisht nuk e përmbushin këtë nivel. Ky kufizim zvogëlon ndjeshëm konkurrencën, duke rritur rrezikun për çmime më të larta dhe për oferta më pak cilësore. Një qasje e tillë bie në kundërshtim me parimin e Efikasitetit dhe Efektivitetit, i cili ka për qëllim sigurimin e vlerës për para për AK-në përmes një gare të hapur dhe gjithëpërfshirëse.
Edhe pse Ligji për Prokurimin Publik (LPP) dhe aktet nënligjore përkatëse e lejojnë vendosjen e një përqindjeje orientuese prej së paku 51% për liderin e GOE, është përgjegjësi e AK-së që të formulojë kritere që nxisin konkurrencën dhe maksimizojnë pjesëmarrjen, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat shpesh nuk e plotësojnë individualisht një prag kaq të lartë si 60%, por mund të jenë shumë të afta në partneritet me të tjerët.
Në këtë rast, AK nuk ka marrë parasysh rëndësinë e përfshirjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke rritur në mënyrë të pajustifikuar përqindjen e kërkuar për liderin e GOE nga minimumi prej 51% në 60%.

Prandaj, kërkojmë nga AK që të rishikojë kriterin aktual dhe të zvogëlojë përqindjen e kërkuar për liderin e GOE nga 60% në 51%, për vlerën e kontratave të natyrës së ngjashme prej 1,485,000.00€, të realizuara brenda tre (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Sqarim Shtesë për OSHP-në në lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Gdhendla Druri (Biomasë)" – Nr. Prokurimit: N/A-25-4874-1-1-1

Në vijim të kërkesës sonë për rishqyrtim të paraqitur ndaj Autoritetit Kontraktues "Ngrohtorja e Qytetit Gjakova" SH.A. dhe pas pranimit të vendimit për refuzim nga ana e AK-së, OE "ETNIKU GROUP" SH.P.K. paraqet pranë OSHP-së edhe këto sqarime shtesë lidhur me paarsyeshmërinë dhe pabazueshmërinë ligjore të këtij refuzimi.

Qëllimi ynë është që OSHP-ja, si organ i pavarur dhe i paanshëm, të shqyrtojë në mënyrë të drejtë dhe të hollësishme këtë aktivitet të prokurimit dhe të nxjerrë një vendim të bazuar në LPP dhe legjislacionin sekondar, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nxitje të konkurrencës.

Çështja I: Parashikimi jo real i vlerës së kontratës
Ne kemi paraqitur argumente të mirë bazuar lidhur me faktin se çmimi për ton i biomasës për vitin 2025 është vlerësuar ndjeshëm më ulët krahasuar me vitin paraprak (2024), duke mos reflektuar as kostot reale të prodhimit, e as trendët aktuale të rritjes së çmimeve në treg.

Argumentet tona janë mbështetur në të dhëna krahasuese ndërmjet çmimit të planifikuar për vitin 2024 dhe atij të vitit 2025, të përcaktuar nga AK "Ngrohtorja e Qytetit Gjakova" SH.A, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Gdhendla Druri (Biomasë)". Gjendja aktuale e tregut dhe natyra e prodhimit të këtij produkti – i cili nuk është një produkt standard, por kërkon procese specifike prodhimi – ndikojnë drejtpërdrejt në kosto, përfshirë përdorimin intensiv të energjisë elektrike dhe derivateve të naftës. Siç dihet këto dy kosto përbërëse të produktit kanë pasur rritje të konsiderueshme të çmimeve në tregun vendor, energjia elektrike është rritur mbi 30%, ndërsa derivatet e naftës janë rritur nga 20% deri në 50%, krahasuar me vitin paraprak. Nisur nga kjo, është evidente se Autoriteti Kontraktues, me ose pa qëllim, ka bërë një vlerësim të pasaktë të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kërkesa jonë është gjithashtu e mbështetur në trendin historik të çmimeve me të cilat Ngrohtorja e Qytetit Gjakova SH.A është furnizuar ndër vite. Që nga viti i parë i operimit, çmimi për ton ka qenë 99.71€, duke shkuar gradualisht deri në 198€/ton në vitet pasuese. Nëse llogarisim një mesatare të këtyre çmimeve, ajo rezulton të jetë rreth 150€/ton – shumë më e lartë se çmimi aktual i planifikuar nga AK për vitin 2025.

Përkundër këtyre fakteve, AK ka refuzuar kërkesën tonë pa hyrë në thelb të saj dhe pa paraqitur asnjë analizë të detajuar të tregut apo ndonjë justifikim të arsyeshëm për uljen e çmimit, në kohën kur kostoja e lëndës drusore, përpunimit, transportit dhe inputeve të tjera të prodhimit të këtij produkti janë rritur ndjeshëm në praktikë.

Për këto arsye, kërkojmë që OSHP-ja të shqyrtojë nëse vlera e kontratës është përcaktuar në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), nëse Autoriteti Kontraktues ka kryer analizën e duhur të tregut para publikimit të dosjes së tenderit dhe nëse AK ka bërë trajtim të drejtë dhe të paanshëm të kërkesës sonë, duke i respektuar parimet e transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Çështja II: Kriteret diskriminuese që kufizojnë konkurrencën

OE "ETNIKU GROUP" SH.P.K. ka paraqitur kundërshtim lidhur me përcaktimin e pragut minimal prej 60% për qarkullimin financiar dhe kontratat e realizuara nga lideri i GOE në tre vitet e fundit, duke kërkuar që ky prag të ulet në 51%, me qëllim të përfshirjes së operatorëve të rinj që kanë kapacitete teknike dhe profesionale për të përmbushur kontratën.

Ky prag:

- Nuk është i detyrueshëm ligjërisht, por **mundësi ligjore**, siç theksohet në nenin 26 të RRPP-së, paragrafi 10.
- Nuk është i justifikuar me ndonjë analizë të tregut nga ana e AK-së.
- E **kufizon padrejtësisht konkurrencën**, duke përjashtuar jo vetëm kompaninë tonë, por edhe operatorë të tjerë potencialë që mund të ofrojnë çmime konkurruese dhe produkt cilësor.

Vendosja e pragut të lartë për Liderin e GOE e pamundëson zbatimin e mundësisë që LPP ua jep OE për t'i bashkuar kapacitetet e tyre për të marr pjesë në aktivitetet e prokurimit dhe bie ndesh me **parimet themelore të LPP-së** për konkurrencë, trajtim të barabartë dhe përdorim të efektshëm të parasë publike.

Bazuar faktet e paraqitura më lartë për trajtimin e padrejtë të kërkesës për rishqyrtim të OE "ETNIK GROUP" SH.P.K kërkojmë nga OSHP-ja që të merret:

VENDIM

I. APROVOHET e bazuar ankesa e OE "ETNIK GROUP" SH.P.K,

II. Të **udhëzojë AK-në që ta rishqyrtojë vlerën e përcaktuar për kontratën**, në përputhje me kushtet reale të tregut dhe kostot e prodhimit si dhe të **ulët pragu i qarkullimit financiar dhe kontratave të realizuara për liderin e GOE nga 60% në 51%**, për të nxitur konkurrencën dhe përfshirjen e NMV-ve.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik "ETNIK GROUP" SH.P.K është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetërore dhe se një diskriminim dhe trajtim jo i barabartë nga ana e autoriteteve kontraktues e dëmton dhe pamundëson materialisht zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarisë së tyre.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";*
b) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve;*
c) *një kopje të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.*